

KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot më datë 20/03/2025, në Tiranë, palët e mëposhtme vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë:

SHITËSI: Z. Renis TËRSHANA, lindur më 23.09.1971, në Tiranë, shtetas Shqiptar, me adresë Rr. Elbasanit, Pallati Tërshana 2, 01101, Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. Personal H10923040R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (në cilësinë e **Shitësit**).

DHE

BLERËSI: Shoqëria “ecs Eco Climate Solution” sh.a., person juridik i të drejtës shqiptare, me NIPT L22218013G, me seli në adresën Njesia Bashkiake nr.7, Rruga “Dritan Hoxha”, Tirana Ring Center, Kati 0, Tiranë, përfaqësuar nga administratori **Z. Edmond Jaupi**, i datëlindjes 21.09.1975, mbajtës i pasaportës me numër personal H50921098S.(në cilësinë e **Blerësit**).

OBJEKTI: Shitja e 1,378,579 (Një milion e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë) aksioneve të “BANKA CREDINS” sh.a, që zotërohen nga aksioneri **Z. Renis TËRSHANA** dhe blerja e tyre nga **Shoqëria “ecs Eco Climate Solution” SH.A.**

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria “BANKA CREDINS” sh.a., është një shoqëri anonime e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 28969, datë 31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT K31608801O, si dhe me licencën nr. 16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE DHE MËNYRA E PAGESËS

Palët kanë rënë dakord që 1,378,579 (Një milion e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë) aksione të shiten me çmimin total prej 2,600,000 (Dy Milion e gjashtëqind mijë) Euro.

Pagesa në shumën e mësipërme do të kryhet në rrugë bankare dhe do të derdhet në llogarinë e Shitësit pranë Bankës Credins.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE

Shitësi është plotësisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë **Blerësit** 1,378,579 (Një milion e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" sh.a, që ai zotëron në kapitalin aksionar të Bankës.

Kalimi i pronësisë do të bëhet me pagesën e plotë të shumës 2,600,000 (Dy Milion e gjashtëqind mijë) Euro nga ana e Blerësit Shoqëria "ecs Eco Climate Solution" sh.a., në llogarinë e Shitësit **Z. Renis TËRSHANA**.

KLAUZOLAT PËR TË DREJTAT MBI DIVIDENTIN DHE TË TJERA

Aksionet objekt kontrate kalojnë dhe transferohen tek Blerësi së bashku me të gjitha të drejtat që shoqërojnë dhe lidhen me aksionet, përfshirë çdo lloj dividendi, rritje kapitali, e drejta e votës, dhe në përgjithësi çdo lloj e drejte tjetër e papërmendur, por që njihet nga statuti dhe ligji. Përfitimi i këtyre të drejtave bëhet së bashku me transferimin e pronësisë mbi aksionet nga Shitësi tek Blerësi me pagesën e çmimit të shitjes së aksioneve.

LIGJI I ZBATUESHËM


Palët bien dakord që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi shitjen.

TË TJERA

Kontrata hartohet në 4 kopje origjinale, duke patur të gjitha vlerë të njëjtë, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e të pavesuar.

SHITËSI

Renis TËRSHANA
SH.A.




BLERËSI

Shoqëria "ecs Eco Climate Solution"

Përfaqësuar nga Administratori:

Edmond JAUPI



2